



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1338/12 Prot.

Durrës më 11/9 2023

V E N D I M

Nr. 52 Datë 11/9 2023

PËR

"Mbi ngritjen e Komisionit të Integritetit Akademik të Fakultetit të Biznesit (KIAF), të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës"

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.685, datë 25.08.2010, 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Statutit të UAMD-së, neni 30, të Rregullores së UAMD-së, neni 28, të Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor, neni 23, pika 2, të shkresës nr. 412 prot., datë 31.05.2023 të Fakultetit të Biznesit, shkresës nr. 930/1 prot., datë 9.06.2023 të Senatit Akademik, shkresës nr.601 prot., datë 4.09.2023, të Fakultetit të Biznesit, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Komisionit për Integritetin Akademik të Fakultetit të Biznesit (KIAF), të Universitetit "Aleksandër Moisiu".
2. Komisioni përbëhet nga 5(pesë) anëtarë, pjesë e stafit akademik me kohë të plotë në Fakultetin e Biznesit, për një mandat 2-vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Drejtuesi i Njësisë Kryesore të Fakultetit të Biznesit.
 - Drejtuesit e Njësisë Bazë të Fakultetit të Biznesit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksanela SOTIROFSKI

